

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONERIT
PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2012

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke konsideruar mbrojtjen e së drejtës së çdo personi për barazi para ligjit, parimin e barazisë dhe trajtimit për shanse dhe mundësi të barabarta, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminim, si përparësi kyçe drejt progresit të shtetit shqiptar;

- Duke inkurajuar dhe mbështetur veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion i pavarur, i cili garanton mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, bazuar në një listë joshtruese arsyeshe të përcaktuara në dispozitat kushtetuese dhe ligjore;

- Duke shprehur bindjen e tij se progresi i veprimtarisë së Komisionerit në drejtim të luftës kundër diskriminimit është i mundur vetëm në sajë të një sistemi harmonizimi dhe koordinimi real të të gjitha strukturave në nivel qendror e vendor, medias, shoqërisë civile dhe publikut;

Vlerëson:

- Zhvillimin institucional dhe arritjet pozitive të veprimtarisë së këtij institucioni në vitin e dytë të plotë të veprimtarisë së tij.

Konstaton se:

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka materializuar punën e tij, bazuar në objektivat që përcakton Plani Strategjik 2012-2015 dhe Plani i Veprimit për vitin 2012, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit për veprimtarinë e tij institucionale gjatë vitit 2012;

- Ka paraqitur, bazuar në raportet zyrtare të institucioneve shtetërore, organizatave jofitimprurëse dhe gjetjeve të rezultuara gjatë veprimtarisë së tij, një vështrim përgjithësues të fenomenologjisë dhe tipologjisë së çështjeve aktuale të diskriminimit;

- Ka synuar zgjerimin e veprimtarisë së tij në drejtim të njohjes institucionale në publik, nëpërmjet shtrirjes rajonale të fushatave gjithëpërfshirëse të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit, lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri;

- Ka rritje të numrit të ankesave të depozituara;

- Ka rritje të numrit të ankesave *ex officio*;

- Ka raste të aplikimit të masës administrative “gjobë”;

- Ka ofruar mbështetje të nismave të ndryshme legjislative, duke propozuar rekomandime ligjore;

- Ka përfaqësuar institucionin në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;

- Ka pasur mbështetjen dhe asistencën e vazhdueshme profesionale të organizmave ndërkombëtarë, që kanë objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kontribuojnë në këtë fushë.

Kuvendi kërkon nga KMD-ja për vitin 2013:

- Të përfundojë në një kohë sa më të shkurtër hetimin e gjithë çështjeve të mbartura prej vitit 2012 dhe të bëjë publike përfundimet e hetimit;

- Të bëjë përpjekje serioze për të rritur aksesin e publikut përmes rritjes së numrit të rasteve të raportuara, ankesave të adresuara nga individë apo organizata të shoqërisë civile dhe kryesisht mes monitorimeve në terren;

- Të verifikojë në mënyrë sistematike, me profesionalizëm dhe në një kohë sa më të shkurtër, informacionet që mbartin ankesat nga individët, mediat, komunitetet, organizatat e shoqërisë civile, lidhur me dyshimet e mundshme për diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë;

- Të konsolidojë profilin publik, si institucion që mbron interesat e qytetarëve, mes rritjes së aksesit të publikut për adresimin e rasteve të mundshme të diskriminimit;

- Të pasurojë faqen *web* të institucionit, duke pasqyruar vendimet e ankesave, si dhe ta përmirësojë atë duke dhënë informacione të plota, të përditësuara dhe aksesuar linke *online*, forume apo sondazhe, me qëllim sigurimin e një komunikimi të vlefshëm, në kohë dhe interes të qytetarëve;

- Të ndërhyjë me veprime ligjore konkrete ndaj institucioneve përkatëse në rastet e diskriminimit

në përgjithësi, atyre të grupeve sociale në veçanti si: individët që diskriminohen për shkak të bindjeve politike, romët, personat me aftësi të kufizuara, individët me orientim seksual të ndryshëm etj.:

- Të rrisë numrin e kontakteve me qytetarët, duke vijuar me praktikën e “Ditëve të hapura” me qëllim për të evidentuar në mënyrë më efikase rastet e diskriminimit;

- Të jetë proaktiv në identifikimin e rasteve të diskriminimit, duke përdorur për rastet *ex officio* edhe burime të tjera të informimit;

- Të rrisë transparencën me publikun dhe institucionet e tjera për ankesat e hetuara, kohëzgjatjen e hetimit, rekomandimet e bëra, zbatimin e tyre nga institucionet shtetërore dhe vendimet e marra, me qëllim sigurimin e një komunikimi të vlefshëm, në kohë dhe interes të qytetarëve;

- Të marrë masa për të përmirësuar metodologjinë e hetimit të ankesave dhe të rrisë efektivitetin e punës së institucionit, mes analizave të rasteve, përmirësimit të përjasjes së ndjekur në trajtimin e rasteve konkrete;

- Të propozojë ndryshimet e nevojshme në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, të cilat kanë lindur si nevojë pas identifikimit të pengesave ligjore nga praktika e punës së tij;

- T’i kushtojë vëmendje të veçantë vlerësimit të perceptimit të publikut rreth diskriminimit dhe formave të shfaqjes së tij, si edhe të bëjë publike gjetjet e studimeve lidhur me çështjet e diskriminimit dhe trendin e zhvillimit të tyre në Shqipëri.

Miratuar në datën 25.3.2013

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)